

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dosja “Revanshi”/ GJKKO shpall vendimin, 50 vite burg për Durim Bamin dhe gjashtë të pandehurit e tje rë
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/15/dosja-revanshi-gjkk-shpall-vendimin-per-durim-bamin-dhe-gjashte-te-pandehurit-e-tjere/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 07:38:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	15 shtator 2026, 07:32:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 15 shtator 2026, 07:31:00 UTC → 15 shtator 2026, 07:33:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e62c7ef048335319e454eff12d042430ed46be3f475d10aec405203c193e41f9
TEKSTI	adb47e72952eebb571d49c726b59ab8b1f30e45bc531027d5f31a0d666b8f681
PAMJA	843fd9a8eb531e05f2415514018ff5a279a77988d920b9cdd68017572dcac0d0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7e6ddf7c3fbf82c48cd73df28fc70289106ed3847beac16e5299c3de1304cc1b
E MËPARSHMJA	9fdbf4cdc89d1d012a060886edc3958d3fefa99d34f0617d04e69fc546eb56d9
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon një rën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7e6ddf7c3fbf82c48cd73df28fc70289106ed3847beac16e5299c3de1304cc1b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET KRYESORE TË FUNDIT

Dosja "Revanshi"/ GJKKO shpall vendimin, 50 vite burg për Durim Bamin dhe gjashtë të pandehurit e tjerë

15/09/2026 09:32



GJKKO ka shpallur vendimin shtatë të pandehurit në kuadër të dosjes "Revanshi".

Të pandehurit janë Durim Bami, Altin Morina, Aldo Avdyli, Jozi Kraja, Henerigert Mitri, Oltion Zefi dhe Edison Jozvik.

Siç raporton gazetaria Anila Hoxha, GJKKO vendosi:

Jozi Kraja 4 vjet e 8 muaj burg

Aldo Avdyli 4 vjet e 8 muaj burg

Oltion Zefi 10 vjet burg

Edson Jozwik 8 vjet burg

Henerigert Mitri 5 vjet e 4 muaj burg

Durim Bami 10 vjet e 8 muaj burg

Altin Morina 6 vjet e 8 muaj

Prokuroria e Posaçme (SPAK) kishte kërkuar këto dënime:

Aldo Avdyli – 10 vite burg, ose 6 vite e 8 muaj me gjykim të shkurtuar.

Edison Jozvik – 15 vite burg, ose 10 vite me gjykim të shkurtuar.

Oltion Zefi – 20 vite burg, ose 13 vite e 4 muaj me gjykim të shkurtuar.

Henerigert Mitri – 9 vite burg, ose 6 vite me gjykim të shkurtuar.

Altin Morina – 13 vite e 6 muaj burg, ose 9 vite me gjykim të shkurtuar.

Jozi Kraja – 10 vite burg, ose 6 vite e 8 muaj me gjykim të shkurtuar.

Durim Bami – 21 vite burg, ose 14 vite me gjykim të shkurtuar.

Njoftimi i SPAK:

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: "Gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurve: Jozi Kraja, Aldo Avdyli (alias Elidon Avdyli), Oltion Zefi, Edson Jozwik (alias Edson Pjetri, alias Edmir Pjetri), Henerigert Mitri, Durim Bami dhe Altin Morina."

2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Alma Kodraliu, Engjëllushe Tahiri

I Kryesore



Seanca për Erion Veliain, trupa e Gjykatës së Lartë futet në Dhomën e Këshillimit për çështjen e kryebashkiakut

10:03

Gjendet një automjet i djegur në zonën e Cerkovinës, dyshohet se është vjedhur kohë më parë për veprimtari të paligjshme

09:41

Trump çmonton politikat e Biden për klimën: Më shumë qymyr dhe gaz natyror për prodhimin e energjisë elektrike

09:30

FOTO/ Zendaya, Selena Gomez dhe yjet e Hollywood-it shkelqejnë në tapetin blu të Emmy Awards

08:15

"Camp Nou" dhe "Wembley" në garë për të pritur finalen e Champions League, sot pritet vendimi i UEFA-s

08:34

I Më të lexuarat

Mbyllet gjyqi ndaj Thaçit në Hagë! Procesi për pengim të drejtësisë, mbrojtja kundërshtoi transkriptet e prokurorisë dhe kërkoi pafajësi

25 mijë euro vetëm pishina/ Email-et dhe dokumentet në dosje, SPAK ia atribuon vilën Belinda Ballukut. Heshtin "Atelier 4" dhe "Green Coast"

Mbretëria e Bashkuar po dridhet/ Skocia, Uellsit dhe Irlanda e Veriut kërkojnë referendum: E ardhmja jonë është në BE

Tensionet zhvendosen në hapësirë, SHBA pranon se ka armë në orbitë: Rusia dhe Kina konsiderohen kërcënimet kryesore

"O kukull, projektligji për kinemanë do deformojë filmin duke futur video-lojëra", Mevlan Shanaj përballtet live në 'Ftesë në 5' me drejtorin e QK, Jorgji: Po flitet keq për njerëz që punojnë

Nga një 'like' në Instagram te propaganda serbe, si u shemb skandali i 'kushteve të këqija' në Tiranë

"FBI kishte mijëra përgjime për Al Caponen, por s'kishte prova", Filip Çakuli: Veliain e arrestuan nga thashethemet, e linçuan publikisht

"China Zorrilla", anija më e madhe elektrike në botë mbërrin në Uruguai, nis udhëtimet në tetor

dhe Rudina Palloj, me vendimin nr. 66, datë 14.09.2026 vendosi:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Jozi Kraja, për kryerjen e veprës penale të "Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje", në dëm të shtetasve D.B dhe V.B, kryer në bashkëpunim të veçantë atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 80 e 28/4 të Kodit Penal, lidhur me veprën penale të "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", të parashikuar nga neni 334 pika 1 i Kodit Penal si dhe në bazë të këtyre neneve dënimin e tij me 6 (gjashtë) vite burgim;

2. Deklarimin fajtor të të pandehurit Jozi Kraja, për kryerjen e veprës penale të "Grup i strukturuar kriminal", në formën e pjesmarrjes, parashikuar nga neni 333/a, paragrafi 2-të i Kodit Penal, si dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me 2 (dy) vite burgim;

3. Në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Jozi Kraja me 7 (shtatë) vite burgim.

4. Bazuar në nenin 406 të K.Pr. Penal, dënimin e të pandehurit Jozi Kraja me 4 (katër) vite e 8 (tetë) muaj burgim.

5. Llogaritja e dënimit me burgim për të pandehurin Jozi Kraja fillon nga dita e arrestimit të tij dhe të kryhet në burg të sigurisë së lartë.

6. Deklarimin fajtor të të pandehurit Aldo Avdyli (alias Elidon Avdyli), për kryerjen e veprës penale të "Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje", në dëm të shtetasve D.B dhe V.B, kryer në bashkëpunim të veçantë atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 80 e 28/4 të Kodit Penal, lidhur me veprën penale të "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", të parashikuar nga neni 334 pika 1 i Kodit Penal si dhe në bazë të këtyre neneve dënimin e tij me 6 (gjashtë) vite burgim;

7. Deklarimin fajtor të të pandehurit Aldo Avdyli (alias Elidon Avdyli), për kryerjen e veprës penale të "Grup i strukturuar kriminal", në formën e pjesmarrjes, parashikuar nga neni 333/a, paragrafi 2-të i Kodit Penal, si dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me 2 (dy) vite burgim;

8. Në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Aldo Avdyli (alias Elidon Avdyli) me 7 (shtatë) vite burgim.

9. Bazuar në nenin 406 të K.Pr. Penal, dënimin e të pandehurit Aldo Avdyli (alias Elidon Avdyli) me 4 (katër) vite e 8 (tetë) muaj burgim.

10. Llogaritja e dënimit me burgim për të pandehurin Aldo Avdyli (alias Elidon Avdyli) fillon nga dita e arrestimit të tij dhe të kryhet në burg të sigurisë së lartë.

11. Deklarimin fajtor të të pandehurit Oltion Zefi, për kryerjen e veprës penale të "Trafikimi i narkotikëve", kryer në formën e bashkëpunimit të veçantë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a paragrafi 1, dhe 28/4 të Kodit Penal, lidhur me veprën penale të "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", të parashikuar nga neni 334 pika 1 i Kodit Penal si dhe në bazë të këtyre neneve dënimin e tij me 13 (trembëdhjetë) vite burgim;

12. Deklarimin fajtor të të pandehurit Oltion Zefi, për kryerjen e veprës penale të "Grup i strukturuar kriminal", në formën e organizimit, parashikuar nga neni 333/a, paragrafi 1 i Kodit Penal, si dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me 4 (katër) vite burgim;

13. Në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Oltion Zefi me 15 (pesëmbëdhjetë) vite burgim.

14. Bazuar në nenin 406 të K.Pr. Penal, dënimin e të pandehurit Oltion Zefi me 10 (dhjetë) vite burgim.

15. Vuajtja e dënimit me burgim për të pandehurin Oltion Zefi të kryhet në burg të sigurisë së lartë, pasi ky i pandehur të arrestohet për efekt të ekzekutimit të vendimit.

16. Deklarimin fajtor të të pandehurit Edson Jozwik (alias Edson Pjetri, alias Edmir Pjetri), për kryerjen e veprës penale të "Trafikimi i narkotikëve", kryer në formë të veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a paragrafi 1, dhe 28/4 të Kodit Penal, lidhur me veprën penale të "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", të parashikuar nga neni 334 pika 1 i Kodit Penal, si dhe në bazë të këtyre neneve dënimin e tij me 12 (dymbëdhjetë) vite burgim;

"Korrupsion, dy vila të fshehura si rryshfet dhe 8 akuza për tenderat", analisti Sulo ngre alarmin: Ç'po ndodh me SPAK? Askush me këto akuza s'i ka shpëtuar arrestit

Kontrollet e reja kufitare të hyrje-daljeve, nëntë vende të BE-së shtyjnë zbatimin e plotë të masave, si do të funksionojë

17. Deklarimin fajtor të të pandehurit Edson Jozwik (alias Edson Pjetri, alias Edmir Pjetri), për kryerjen e veprës penale të "Grup i strukturuar kriminal", në formën e pjesëmarrjes, parashikuar nga neni 333/a, paragrafi 2 i Kodit Penal, si dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me 2 (dy) vite burgim;

18. Në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Edson Jozwik (alias Edson Pjetri, alias Edmir Pjetri) me 12 (dymbëdhjetë) vite burgim.

19. Bazuar në nenin 406 të K.Pr. Penal, dënimin e të pandehurit Edson Jozwik (alias Edson Pjetri, alias Edmir Pjetri) me 8 (tetë) vite burgim.

20. Llogaritja e dënimit me burgim për të pandehurin pandehurin Edson Jozwik (alias Edson Pjetri, alias Edmir Pjetri) fillon nga dita e arrestimit të tij dhe të kryhet në burg të sigurisë së lartë.

21. Deklarimin fajtor të të pandehurit Henerigert Mitri, për kryerjen e veprës penale të "Kultivimi i bimëve narkotike", kryer në formë të veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 284 paragrafi 1, dhe 28/4 të Kodit Penal, lidhur me veprën penale të "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", të parashikuar nga neni 334 pika 1 i Kodit Penal si dhe në bazë të këtyre neneve dënimin e tij me 8 (tetë) vite burgim;

22. Deklarimin fajtor të të pandehurit Henerigert Mitri, për kryerjen e veprës penale të "Grup i strukturuar kriminal", në formën e pjesëmarrjes, parashikuar nga neni 333/a, paragrafi 2-të i Kodit Penal, si dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me 2 (dy) vite burgim; 23. Deklarimin fajtor të të pandehurit Henerigert Mitri, për kryerjen e veprës penale të "Shpërdorimi i detyrës" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, si dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me 1 (një) vit burgim;

24. Në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Henerigert Mitri me 8 (tetë) vite burgim.

25. Bazuar në nenin 406 të K.Pr. Penal, dënimin e të pandehurit Henerigert Mitri me 5 (pesë) vite e 4 (katër) muaj burgim.

26. Llogaritja e dënimit me burgim për të pandehurin Henerigert Mitri fillon nga dita e arrestimit të tij dhe të kryhet në burg të sigurisë së lartë.

27. Deklarimin fajtor të të pandehurit Durim Bami, për kryerjen e veprës penale të "Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje", në dëm të shtetasit A.N, kryer në bashkëpunim të veçantë atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 80 e 28/4 të Kodit Penal, lidhur me veprën penale të "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", të parashikuar nga neni 334 pika 1 i Kodit Penal si dhe në bazë të këtyre neneve dënimin e tij me 8 (tetë) vite burgim;

28. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Durim Bami, për kryerjen e veprës penale të "Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje", në dëm të shtetasve T.Xh dhe E.M, kryer në bashkëpunim të veçantë atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 80 e 28/4 të Kodit Penal, lidhur me veprën penale të "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", të parashikuar nga neni 334 pika 1 i Kodit Penal.

29. Deklarimin fajtor të të pandehurit Durim Bami, për kryerjen e veprës penale të "Grup i strukturuar kriminal", në formën e krijimit, drejtimit apo organizimit, parashikuar nga neni 333/a, paragrafi 1 i Kodit Penal, në lidhje me veprat penale kundër jetës, si dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me 3 (tre) vite burgim;

30. Deklarimin fajtor të të pandehurit Durim Bami, për kryerjen e veprës penale të "Kultivimi i bimëve narkotike", e kryer në formë të veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 284 paragrafi 1 dhe 28/4 të Kodit Penal, lidhur me veprën penale të "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", të parashikuar nga neni 334 pika 1 i Kodit Penal, si dhe në bazë të këtyre neneve dënimin e tij me 10 (dhjetë) vite burgim;

31. Deklarimin fajtor të të pandehurit Durim Bami, për kryerjen e veprës penale të "Grup i strukturuar kriminal", në formën e krijimit, drejtimit apo organizimit, parashikuar nga neni 333/a, paragrafi 1 i Kodit Penal, në lidhje me kultivimin e bimëve narkotike, si dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me 3 (tre) vite burgim;

32. Në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Durim Bami me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vite burgim.

33. Bazuar në nenin 406 të K.Pr. Penal, dënimin e të pandehurit Durim Bami me 10 (dhjetë) vite e 8 (tetë) muaj burgim.

34. Llogaritja e dënimit me burgim për të pandehurin Durim Bami fillon nga dita e arrestimit të tij dhe të kryhet në burg të sigurisë së lartë.

35. Deklarimin fajtor të të pandehurit Altin Morina, për kryerjen e veprës penale të "Kultivimi i bimëve narkotike", kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 284, paragrafi 1 dhe 28/4 të Kodit Penal, lidhur me veprën penale të "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", të parashikuar nga neni 334 pika 1 i Kodit Penal si dhe në bazë të këtyre neneve dënimin e tij me 8 (tetë) vite burgim;

36. Deklarimin fajtor të të pandehurit Altin Morina, për kryerjen e veprës penale të "Grup i strukturuar kriminal", në formën e pjesmarrjes, parashikuar nga neni 333/a, paragrafi 2-të i Kodit Penal, si dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me 2 (dy) vite burgim;

37. Deklarimin fajtor të të pandehurit Altin Morina, për kryerjen e veprës penale të "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit", në formën e mbajtjes së armëve, në automjete pa lejen e organeve kompetente shtetërore, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, si dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me 5 (pesë) vite burgim;

38. Pushimin e çështjes penale ndaj të pandehurit Altin Morina, për kryerjen e veprës penale të "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit", në formën e mbajtjes së municioneve luftarake pa lejen e organeve kompetente shtetërore, parashikuar nga neni 278 paragrafi 3 i Kodit Penal.

39. Në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Altin Morina me 10 (dhjetë) vite burgim.

40. Bazuar në nenin 406 të K.Pr.Penale, dënimin e të pandehurit Altin Morina me 6 (gjashtë) vite e 8 (tetë) muaj burgim.

41. Llogaritja e dënimit me burgim për të pandehurin Altin Morina fillon nga dita e arrestimit të tij dhe të kryhet në burg të sigurisë së lartë.

42. Në bazë të gërmave "a" dhe "b" të pikës 1 të nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në bazë të gërmave "a" dhe "d" të pikës 1 të nenit 36 të Kodit Penal, të konfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit si sende të cilat kanë shërbyer për kryerjen e veprës penale, apo që prodhimi, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i tyre përbëjnë vepër penale, sendet e sekuestruara të pandehurit Altin Morina me procesverbalin e datës 04.04.2025 ora 03:00, të cilat pas kryerjes së aktit Nr **** datë 08.05.2025 të ekspertimit Teknik arme e fishekësh dhe balistik gëzhgojash, janë lënë në ruajtje në magazinën e armatimit të Drejtorisë Vendore Tiranë me procesverbalin e lënies në ruajtje të datës 23.05.2025, konkretisht: një armë zjarri pistoletë me mbishkrim "****", me numër "****", me një krëhër pistolette dhe 7 (shtatë) fishekë luftarak me kapsollë të pa goditur, të mbetur pas ekspertimit, konkretisht: 1. Pistoleta me mbishkrim "****", me numër "****"; 2. Një krëhër pistolette dhe 7 (shtatë) fishekë luftarak me kapsollë të pa goditur, të mbetur pas ekspertimit teknik arme dhe fishekësh Nr **** datë 08.05.2025;

43. Në bazë të nenit 485 të K. Pr. Penale, t'u ngarkohen solidarisht të pandehurve shpenzimet proceduriale të kryera gjatë hetimeve paraprake, si dhe ato të kryera në gjykim. 44. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

Top Channel

I Aktualitet »



LAJMI I FUNDIT/ Gjykata e Lartë merr vendimin për Veliajn, kryebashkiaku mbetet në burg


15/09 11:06

Shpërthim me lëndë plasëse në një banesë në Shijak, nuk raportohet për të lënduar

15/09 10:51

Cënuan perimetrin e sigurisë në shkollë gjatë tubimit të djeshëm, arrestohen 12 protestues, procedohen 15 të tjerë

15/09 10:39



Si disa vatra zjarri në pyje kullota në Himarë, arrestohet në flagrancë 52-



Ish-bashkëshorti i plagosi të atin me drapër, rrëfëhet gruaja nga Roskoveci: Më ka dhunuar



Seanca për Erion Veliajn, trupa e Gjykatës së Lartë futet në Dhomën e Këshillimit për

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.